



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:019087

Datë: 03.06.2021

Numri i dokumentit: 01847122

P.nr.1014/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI I PËRGGJITSHËM DIVIZIONI PENAL, si gjykatë e shkallës së parë penale me gjyqtarin e vetëm gjykues Ilir Bytyqi, me procesmbajtësen Florijana Pajaziti, praktikante, në lëndën penale kundër të akuzuarit Xh.V me vendbanim Komuna Ferizaj, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.II.nr.1002-5/18 të datës 22.05.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik në prezencën e Prokurores së Shtetit Zana Sadiku-Setrolli, përfaqësuesit juridik të dëmtuarit KEDS, Besart Selmani, si dhe të akuzuarin Xh.V me av. mbrojtës Labinota Qosa-Ilazi, me datë 26.05.2021 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 03.06.2020 përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari: Xh.V i lindur me dt..... në K. Ferizaj, nga i ati H. dhe nëna N. e vajzërisë Z., me vendbanim Komuna Ferizaj, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, pronar i firmës “Xh.... D....”, posedon letërnjoftim me numër personal.....

ËSHTË FAJTOR

Me datë 28 Mars 2017, rreth orës 15:00, në rrugën magjistrale Ferizaj – Prishtinë, saktësisht në biznesin “Xh.... D....r”, nga punëtorët e KEDS-it, është konstatuar se konsumatori ka bërë keqpërdorimin e energjisë elektrike, në atë mënyrë që është kyç direkt në KPO, jashtë

pikës matëse me kabull në formë të shtypalkes dhe për pasoj energjia e shpenzuar nuk është regjistruar, me c'rast i ka shkaktuar dëme materiale KEDS-it ne vlere 4,117.42 Euro.

**me këtë ka kryer veprën vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 314 par. 1 të
KPRK-së.**

Andaj, gjykata në bazë të neneve të sipër cekur dhe neneve 2, 3, 4, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 38, 39, 43 dhe 69 dhe 70 të KPRK-ës, dhe nenit 365 të KPPK-së, të akuzuarin Xh.Ve

G J Y K O N

- Dënim me gjobë në shumë prej 400 Euro (katërqind euro), të cilën gjobë obligohet ta paguaj në afat prej 30 ditëve pasi që aktgjykimi e merr formën e prerë, nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë.
- Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra të tjera të parapara me nenin 43 par. 3 të KPRK-së, do të ekzekutohet në atë mënyrë që te akuzuarit për çdo 20€, do të vuaj 1 (një) ditë burgim.
- Obligohet i akuzuari Xh.V., në emër të kërkesës pasurore juridike të dëmtuarës KEDS-Distrikti në Ferizaj, t'i kompensoj shumën e demit 4,117.42 Euro, (katërmijë e njëqind e shtatëmbëdhjetë euro dhe katërdhjet e dy cent) këto në afat prej 3 Muajve nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi.
- Obligohet i akuzuari që në ne emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 Euro (tridhjetë), si dhe shpenzimet e procedurës penale per ekspertiz financiare në shumën prej 200 Euro (dyqind), të gjitha këto në afatin prej 30 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.
- Obligohet i akuzuari që konform nenit 39 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 05/L-036, për kompensimin e viktimave të krimit, të paguaj shumën prej 30 Euro (tridhjetë), në afatin prej 30 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

A r s y e t i m i

Historiku i procedurës

Prokuroria Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur aktakuzën PP.II.nr.1002-5/18 të datës 22.05.2018 kundër të akuzuarit Xh.V me vendbanim Komuna Ferizaj, për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së.

Gjykata Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm, duke vepruar sipas udhëzimeve të Gjykatës së Apelit PA1.nr.765/2020 të dt.25.11.2020, në këtë çështje penale caktoi dhe mbajti shqyrtimin gjyqësor me datat 10.02.2021, 05.05.2020 dhe 25.05.202, ku janë prezantuar prokurori i shtetit Luljeta Bilalli, përfaqësuesi juridik i te dëmtuarës KEDS, Besart Selmani, i akuzuari Xh.V dhe avokati mbrojtës me autorizim Labinota Qosa-Ilazi. Gjykata themelore në Ferizaj, ka mbajtur shqyrtimet gjyqësore

Fillimisht ky rast penal është iniciuar për te akuzuarin N.I (pronarin e paluajtshmeris), prokurori i shtetit ne fjalën përfundimtare ka heq dore nga ky ne mungese te vërtetimit te elementeve te veprës penale dhe ka akuzuar për te njëjtën vepër penale Xh.V shfrytëzuesin dhe poseduesin e paligjshmërisë. (shiko fashikullin e lëndës penale me aktgjykim refuzues P.nr.1813/17 te dt. 30.04.2018).

I akuzuari Xh.V me rastin e deklarimit të fajësisë apo pafajësisë u deklarua i pafajshëm për veprën penale për të cilën është akuzuar.

Mbrojtja e të akuzuarit

I akuzuari Xh.V në rigjykim ka deklaruar se mbetet pranë mbrojtjes se dhënë në shqyrtimit gjyqësor me dt. 06.07.2020, i njëjti nuk ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar.

I njëjti në mbrojtjen e tij në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se ka nje objekt afarist me qira ne shfrytëzim sipas kontratës formale te dt. 01.09.2016 por jo te vërtetuar nga noteri. Ditën kritike ka pasur një kontroll nga zyrtaret e KEDS-it, ky është paraqitur thujse ne fund te kontrollit vetëm pasi e ka njoftuar një punëtorë i tij, nuk e kane njoftuar se kane zene ndonjë kaboll por vetëm e kane njoftuar se kane bere kontroll rutinore, ky personalisht ka refuzuar ta nënshkruar procesverbalin e te gjeturave gjate kontrollin sepse nuk ka qene dakord me at ecka

kane konstatuar zyrtaret e KEDS-it, kontrollin e kane bere ne orët e pasdites si dhe fotot e kontrollit nuk ka qene prezent dhe as një punëtor.

I akuzuari një pjese te mbrojtjes e orienton në atë se kabllot me shtypalka qe janë fotografuar i kane shërbyer për një gjeneratorë i cili energjinë e bene nga një kultivator, me këtë kultivator prodhon rreth 2 KW energji, ndërsa njehsori elektrik gjendet brenda objektit dhe qasje nga jashtë nuk mund te këtë.

Provat e paraqitura në shqyrtimin gjyqësor

Pasi që i akuzuari nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së, Gjykata ka bërë paraqitjen e provave në shqyrtimin gjyqësor dhe pas vlerësimit të tyre një nga një dhe duke i ndërlidhur reciprokisht njëra me tjetrën, në kuptim të dispozitës së nenit 361 par.1 dhe 2 të KPPK-së, vërtetohet gjendjen faktike të përshkruar hollësisht në dispozitivin e këtij aktgjykimi:

Gjykata gjendjen e tillë faktike e ka vërtetuar përmes provave të prezantuara në shqyrtimin gjyqësor dhe atë:

- Nga dëshmia e dëshmitarit A.A – ekspert i monitorimit dhe kontrollit te humbjeve;
- Nga dëshmia e dëshmitarit E.H – ekspert i monitorimit dhe kontrollit te humbjeve;
- Nga procesverbali me rastin e kontrollit nr. 0724960 te dt. 28.03.2017;
- Prova materia mbi dëmin e shkaktuar fatura e dt. 29.03.2017;
- Ekspertiza financiare Nr.053/2021 të dt.14.04.2021;
- Fotografit te cilat gjenden ne shkresat e lendes;
- Kontrata mbi qiranë e lokalit afarist te dt. 01.09.2016 ne mes te N.I – qiradhënës dhe D... “Xh... D..” – qiramarrës Xh.V;
- Gjendja e përgjithshme e deklarimeve ne ATK dt.18.06.2020 ne emër te biznesit “M... H...” pronar Xh.V;
- Pjesërisht edhe nga vetë mbrojtja e të akuzuarit Xh.V.

Vlerësimi i provave të paraqitura në shqyrtimin gjyqësor

Fillimisht Gjykata vlerëson si të pakontestueshme dhe të provuara faktet dhe rrethanat e mëposhtme:

Me datë 28 Mars 2017, rreth orës 15:00, në rrugën magjistrale Ferizaj – Prishtinë, saktësisht ne biznesin “Xh.... D....”, nga punëtorët e KEDS-it, është konstatuar se konsumatori ka bërë keqpërdorimin e energjisë elektrike, në atë mënyrë që është kyç direkt në KPO, jashtë pikës matëse me kabull në formë të shtypalkes dhe për pasoj energjia e shpenzuar nuk është regjistruar, me c’rast i ka shkaktuar dëme materiale KEDS-it ne vlere 4,117.42 Euro.

Dëshmitari A.A – ekspert i monitorimit dhe kontrollit te humbjeve, në shqyrtimin gjyqësor ka vërtetuar se: qe 20 vite është i punësuar ne KEK dhe tani pjesën e KEDS-it, ndërsa nga viti 2014 punon ne pozitën e ekspertit te monitorimit dhe kontrollimit te humbjeve komerciale, qe detyre kryesore ka obligim te monitoroj dhe kontrolloj humbjet e energjisë elektrike, kontrollimin e pikave matëse te energjisë ne teren. Ndërsa saktësisht me datën 28.03.2017 ky se bashku me koleget A.G dhe E.H kane shkuar për kontroll te konsumatori “Xh.... D...” i cili gjendet ne rrugën magjistrale Ferizaj-Prishtinë, fillimisht kane hyre ne oborr kane kontaktuar me disa punëtor dhe janë prezantuar qe janë zyrtare te KEDS-it, ne atë moment njeri nga punëtorët ka vrapuar ne drejtim te njehsorit elektrik, këta i kane shkuar mbrapa dhe e kane përcjell dhe kane verë re se ka manipuluar me ndërpresin e njehsorit dhe i ka zhvendos kabllot te cilat i kishte te kyqura ne kutin kryesore jashtë pikës matëse, pastaj i kane bere disa fotografi ne vendin e ngjarjes ku shihet kabllot e vendosur ne mënyrë ilegale dhe ne ndërkohë kane përpiluar procesverbalin dhe i kane konstatuar te gjeturat. Kane evidentuar pajisjet qe kane shërbyer për qëllim të biznesit qe ka ushtruar aty.

Dëshmitari tutje vërteton se pësoni i cili ka hequr kabllot ishte prezantuar si punëtor ndërsa pronari (aludon ne te akuzuarin) është ardhë me pas, i njëjti ka refuzuar ta nënshkruar procesverbalin ndërsa njehsori elektrik ka qene mesa i kujtohet ne emër te N.I a shfrytëzues ka qene biznesi “Xh... D....”. Njehsori elektrik ka qene brenda objektit kabllot janë ndërtuat ne atë mënyrë qe siç shihet ne foto me shypalka ekskluzivisht ndërtohen për te keqpërdorur energjinë elektrike. Dëshmitari shpjegon fotografit e bëra ne vendin e ngjarjes si ne vijim: nga foto nr. 1 është ndërprerësi i gjeneratorit ku pozicionohet ne pozitën nr. një, nënkupton qe energjia shkon përmes njehsorit elektrik, ndërsa pozicioni nr. 2 është rruge tjetër alternative e cila shfrytëzohet nga gjeneratori ose ndonjë burim tjetër, foto nr. 3 shihet një kablo e cika ka bartur energjinë elektrike nga orman shpërndarës deri teke ndërprerësi, ne foton nr. 4 shihet përçuesit te cilët kane qene me klema te vendosura ne kutin shpërndarëse kryesore, ne foton nr. 5 janë katër shtypalka te cilat tri prej tyre vendosen ne siguresa ku ka tension kurse njëra vendoset ne piken

0 dhe përmes këtyre kabllove e cila lidhet me kabllon e gjeneratorit nëpërmjet gjekut kalon ne ndërprerësin 1, 0 dhe 2 dhe furnizon objektin me energji elektrike jashtë pikës matëse.

Dëshmitari E.H – ekspert i monitorimit dhe kontrollit te humbjeve, në shqyrtimin gjyqësor ka vërtetuar se: nga viti 2010 punon ne pozitën e sipërcekur per detyrë ka monitorimin ne terren, ndërsa me datën 28.03.2017 se bashku me koleget A.G. dhe A.A kane qene ne kontroll te konsumatori “Xh.... D....” i cili gjendet ne magjistralen Ferizaj-Prishtine, kontrollet zakonisht i bëjnë ne ato trafo ku ka rezultuar ne humbje te energjisë elektrike (cdo trafo ka njëhsor elektrik), ne trafon konkrete është furnizuar me energji edhe konsumatori (i akuazuari), te ky konsumator fillimisht janë prezantuar si zyrtar te KEDS-it, ku fillimisht është paraqitur një punëtorë i cili me ta kuptuar faktin se kush janë ka vrapuar ne drejtim te kap ormanit ku kishte te vendosura shtypalka (klema), dhe nga kjo lidhje energjia qe është shpenzuar nuk është regjistruar. Dëshmitari tutje shpjegon edhe formën e këtyre shtypalkave te cilat janë si ne forme te klemave për ndezje te veturave, ne këtë mënyrë inprovizohen dhe te njëjtat kane qene te kapura ne kap orman, afër ka qene edhe ndërprerësi 1, 0 dhe 2. Pra kjo e fundit 2 është pa matje dhe mundëson vjedhjen e energjisë elektrike kur shtypalkat vendosen ne siguresa kryesore dhe nëpërmjet kablllos se gjeneratorit e ka furnizuar me energji tere objektin. Për ta dëshmuar këtë kane bere edhe fotografit nga vendi i ngjarjes, procesverbalin (nuk e ka nënshkuare pala).

Nga prova materiale procesverbali i bërë në vendin e ngjarjes me nr. 0724960 te dt. 28.03.2017, vërtetohet personat e autorizuar nga KEDS, të përbërë nga tre zyrtare, kanë qenë në kontroll te konsumatori – emërtimi i veprimtarisë “Xh... D....” dhe kane gjetur se me rastin e kontrollit njeri nga punëtorët ka vrapuar te pika matëse për ta ndrruar ndërprerësin nga pika 2 ne piken 0, i kane shkuar pas punëtorit dhe kane vërejtur se pala përmes shtypalkave kyç ne KPO (pak orman) kabllon e gjeneratorit ne rrjet elektrik dhe përmes ndërprerësit 1, 0 dhe 2 manipolon dhe energjia e shpenzuar nuk matet. Ne këtë procesverbal kanë konstatuar pese rubrika me aparate për ushtrimin e veprimtarisë metal punuese edhe aparatet siç janë aparati saldues 1 cope fuqia 1056 W, kompresora dy cope fuqia 2500 W, fleka të mëdhej 2 cope 1860W, fleka të vogël 0.850 dy copë, thithse elektrike, hillt, poqa etj.

Nga prova materiale fatura e dt. 29.03.2017, është konstatuar dëmi në formë të rikthimit te humbjeve për biznese ne afat prej 12 muaj, shuma totale e demit është 4,117.42 euro. Ndërsa prova materiale fotografit te cilat gjenden ne shkresat e lëndës dëshmojnë mjetin me te cilën ka përdorë për ta mundësuar kryerjen e veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale, formën e

kabllove, mënyrën si i ka lidhe shtypalkat për ti kap në siguresa, forma, gjatësia, gjerësinë. Prova materiale kontrata mbi qiranë e lokalit afarist te dt. 01.09.2016, e lidhur ne mes qiramarrësit Xh.V dhe qiradhënësit N.I, vërteton periudhën kohore te posedimit, shfrytëzimit dhe mbikëqyrjes përfshirë edhe shërbimet komunale, ujin, rrymën dhe mbeturinat. Ndërsa pasqyra e Administratës Tatimore te Kosovës vërteton gjeneralët e subjektit juridik, tatimpaguesi është i regjistruar per llojet e tatimeve siç është TVSH, periudhën kohore gjendjen e përgjithshme te deklarimeve dhe transaksioneve te tjera, por qe nuk i shërben mbrojtjes për ta shfajësuar te akuzuarin apo ndonjë periudhë kohore.

Nga provat materiale kontrata mbi lokalit afarist e lidhur me dt.01.09.2016, mes N.I – Qiradhenes dhe D... “Xh.... D...” Xh.V., vërtetojnë se shfrytëzues në kohen kur është keqpërdorë energjia elektrike është Xh.V, kontrata ne fjalë është prezantuar ne kohen sa i akuzuar ishte N.I, jo kontestuese për palët në kontratë, e njëjta eshte hartuar pas ngritjes se aktakuzës se parë në zyrën respektivisht te avokatja e cila ka përfaqësuar te akuzuarit, mirëpo që kontrata në fjalë nuk është e noterizuar sepse sipas bindjes së kesaj gjykate me dashje nuk e ka mundur gjithë periudhën kohore te rikthimit te demit per biznes për dymbëdhjetë muaj, në mënyrë që pjesën tjetër ta udhëzojë për dëme ne kontest civil, por që ekspertiza financiare ka vërtetuar se faturimi i bazuar ne kalkulimin RH (rikthimi i humbjes) ka rezultuar në rregull referuar nenit 31 par. 1 te rregulla për kushtet e përgjithshme te furnizimit me energji elektrike, zyra e rregullatorit për energji Shkurt 2017.

Nga prova materiale ekspertiza financiare e bërë pas udhëzimeve të gjykatës së apelit eksperti financiar V.I., vërteton se shfrytëzimi i lokalit sipas kontratës duke filluar nga data 01.09.2016 është D.. “Xh... D...”, NRB..... me drejtor Xh.V. me nr. Personal....., shfrytëzimin i lokalit përfshinë periudhën prej 01.09.2016 deri 28.03.2017 që i bije 6 muaj e 28 ditë. Kalkulimi i rikthimit te humbjes (RH) rasti; te dt.29.03.2017 përfshin periudhën prej 12 muaj, sipas këtij kalkulimi detyrimi mujor është 317.70 euro pa TVSH dhe 25.42 euro TVSH, gjithsejtë 343.12 euro ne muaj. Faturimi i bazuar ne këtë kalkulim te RH. ka rezultuar ne rregull bazuar ne nenin 31 par. 1 te rregullores për kushte e përgjithshme te furnizimit me energji e nxjerr nga zyra e rregullatorit për energji, shkurt 2017, vlera e faturës është 4,117.42 euro. Mbështetur ne te gjithë dokumentacionin e lendes dhe elaborimin si me sipër rrjedh se ne mendimin dhe konstatimin përfundimtar të eksperti se faturimi i bazuar ne kalkulimin RH (rikthim i humbjes), ka rezultuar në rregull, i bazuar ne nenin 31 par. 1 te rregullat për kushte e

përgjithshme të furnizimit me energji e nxjerr nga zyra e rregullatorit për energji shkurt 2017, dhe vlera e demit sipas faturës është 4,117.42 euro.

Eksperti financiar edhe gjatë shqyrtimit kryesor ka mbet pranë ekspertizës financiare pa ndryshim dhe plotësim, deri sa gjate sqarimeve në pyetjet e av. mbrojtës ka vërtetuar sasinë e kilovatëve të shpenzuar fillimisht e ka kryer grupi i eksperteve nga ana e të dëmtuar bazuar në pajisjet që shfrytëzojnë energjinë elektrike dhe që ishin aktiv edhe përlllogaritja e kapacitetit shfrytëzues për periudhën shfrytëzuese edhe bere në mënyrë të drejt, përlllogaritja behet në baza mujore por pasi që në këtë rast kemi të bëjmë subjekt juridik përlllogaritja behet vjetore, gjatë përpilimit të ekspertizës ka përdorë edhe kontratën mbi qiranë dhe provat tjera materiale.

Vlerësimi i mbrojtjes të të akuzuarit

Gjykata çmoj dhe vlerësoj mbrojtjen e të akuzuarit Xh.V se ditën kritike nuk është e vërtet se ka keqpërdorur energjinë elektrike neper mjet kablove të lidhura në forme të shypalkave të kapura në siguresat kryesore para KPO-se (pak ormanit) e njohur si lidhje direkte jashtë pikës matëse, mirëpo gjykata një mbrojtje të tillë nuk e aprovojë nga fakti se gjatë administrimit të provave gjegjësisht dëgjimit të dëshmitareve A.A dhe E.H – ekspertë të kontrollimit dhe monitorimit të humbjeve u vërtetuar se ditën kritike rreth orës 15:00, gjatë një kontrolli të bere të konsumatori Xh.V(subjekti afarist metalurgjik Xh...D...), kanë hasë në lidhje direkte jashtë KPO-se, për pasoj energjia e shpenzuar nuk është regjistruar, me c’rast i kanë bere dëm material KEDS-it në shumën prej 4,117.42 euro të vërtetuar edhe me faturën për kalkulim të demit të dt. 29.03.2017, faktin edhe me bindes se i pandehuri është kryer i kësaj veprë penale e vërtetojnë edhe materiale të cilat ndërlidhen në mes vete siç janë procesverbali me rastin e kontrollit nr. 0724960 të dt. 28.03.2017, fotografit të cilat gjenden në shkresat e lëndes dhe kontrata mbi qiranë e lokalit afarist të dt. 01.09.2016 në mes të N.I. – qiradhënës dhe D... “Xh... D...” – qiramarrës Xh.V.

Rikualifikimi juridik i veprës penale & Vlerësimi ligjor i veprimeve të akuzuarit

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale lidhja e paautorizuar në shërbime nga

neni 314 par. 1 të KPRK-së, ashtu siç është theksuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi, të përshkruar në datën, vendin, kohën dhe mënyrën apo rrethanat e kryerjes. Konform nenit 3 par. 2 të KPRK-së, në rastin konkret gjykata ka zbatuar ligjin me te favorshëm ndaj kryesit ku përcakton se nëse ligji ne fuqi ndryshon para shqiptimit të vendimit të formës së prerë, atëherë ndaj kryesit zbatohet ligji që është më i favorshëm. Ligji i vjetër nr.04/L-082 neni 320 ka përcaktua dënim komulativ deri sa li gji ri nr.06/L-074 neni 314 ka përcaktuar dënim alternativ.

Në shqyrtimin gjyqësor, gjyqtari i vetëm gjykues ka bërë ricilësimin e veprës penale, me arsyetim se me datën 14.04.2019 ka hyrë në fuqi Kodi Penal i Republikës së Kosovës 06/L-074 dhe atë nga vepra penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së (Kodi nr. 04/L082), në veprën penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK-së (Kodi nr.06/L074). Institut ky më i favorshëm për të pandehurin bazuar në dispozitën ligjore të nenit 3 par. 2 të KPRK-së, ku shprehimisht përcakton se në rast së ligji në fuqi ndryshon para shqiptimit të vendimit të formës së prerë at'here ndaj kryesit zbatohet ligji më i favorshëm.

Veprimet e kundërligjshme të kryera nga i pandehuri kanë cenuar marrëdhëniet juridike të vendosura me ligje për ruajtjen e paprekshmërisë së pronës dhe të drejtave pasurore të personave fizik dhe juridik, kjo vepër është kryer me ane të veprimeve aktive dhe të kundërligjshme duke vendosur një kabllo në forme të shtypalkave para kap ormanit, veprimet këto të kryera me dashje direkte dhe me qëllim të posaçëm për të nxjerr përfitime materiale, pasi që i pandehuri jo vetëm që ka parashikuar pasojat e veprimeve të tij por edhe ka dëshiruar edhe ardhjen e tyre, çka rezulton nga tërësia e rrethanave të kryerjes së veprës penale.

Fjala përfundimtare e palëve

Prokurorja e Shtetit Zana Sadiku-Sertolli në fjalën përfundimtare ka deklaruar se gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe administrimit të provave u vërtetua dyshimi i bazuar mirë se i akuzuari është kryes i veprës penale dhe me dashka ka përvetësuar në mënyrë të kundërligjshme energjinë është lidhur direkt në KPO jashtë pikës matëse, ku energjia e shpenzuar nuk është regjistruar fare, ky fakt është vërtetuar nga dëgjimi i dëshmitareve A.A. edhe E.H, të cilat dëshmi kanë mbështetje edhe në provat materiale siç janë procesverbali, fotografitë e vendit të ngjarjes si dhe fatura për vlerësimin e demit.

Deshmitaret e sipër cekur kane vërtetuar faktin se ditën kritike ne vendngjarje ishin ne kontroll te konsumatori “Xh... D...”, respektivisht i akuzuari Xh.V.dhe se kanë hasur ne keqpërdorimin e energjisë elektrike, ku nga kryesi i kësaj vepre ishte bërë lidhja direkte duke anashkaluar piken matëse te energjisë elektrike edhe atë i njëjti kishte lidhur disa kablllo, me te cilat ka bere furnizimin direkt te energjisë elektrike pa u regjistruar si shpenzues. Se i akuzuari është edhe shfrytëzues i energjisë elektrike ne kohen e kryerjes se veprës penale e ka vërtetuar vete i pandehuri, se nga muaji shtator i vitit 2016 ka marr ne shfrytëzim lokaln nga i cili edhe është bere keqpërdorimi i energjisë, prandaj pas vlerësimit te gjithanshëm dhe te drejte te provave te administruara i propozon gjykatës qe ta shpalle fajtor dhe te i shqiptoj nje dënim i cili do te jete ne proporcion me peshën e veprës penale.

Ndërsa ekspertiza financiare e dt.14.04.2021 e përpiluar në eksperti V.I, provon qartazi me veprimet e te pandehurit i ka shkaktuar dëm material të dëmtuarës KEDS-Distrikti Ferizaj ne vlere prej 4,,114.42 euro, si dhe nga fotodokumentacioni i vërtetua keqpërdorimi apo ndërhyrja qe është bërë ne njehsorin elektrik pa autorizim te furnizuesit te energjisë elektrike. Prandaj pas vlerësimit te gjithanshëm dhe te drejt te provave materiale dhe personale si dhe duke i qmuar dhe ndërlidhur ne kontestin logjik dhe faktik me njëra tjetrën i propozon gjykatës te akuzuarin ta shpall fajtor dhe te dënoj sipas ligjit.

Përfaqësuesi juridik i KEDS-it, Besart Selmani, ne fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështet ne tërësi fjalën përfundimtare te prokurorit te shtetit, duke shtuar se i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe parashtron kërkesë pasurore-juridike siç është e përcaktuar ne dëshminë e cila gjendet ne shkresat e lëndës.

Mbrojtja e te akuzuarit, av. Labinota Qosa-Ilazi në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pas administrimit te provave materiale, dëgjimit te ekspertit financiar, prokuroria ka dështuar te argumentoj se Xh.V te këtë vjedhur shërbime komunale ne shumen e specifikuar ne dispozitiv te aktakuzës. Për te akuzuar një person juridik apo civil nuk mjafton te thirremi veten ne një procesverbal si rasti ne fjalë edhe at i përpiluar nga ana e KEDS-it pala e dëmtuar, procesverbali në fjalë nuk janë specifikuar elementet e veprës penale. Po ashtu si shkresa e lendes është administruar edhe fatura e përpiluar nga e dëmtuara e cila kap shifrën 4,117.42 euro, kjo shume ka qrdhur si rezultat e kalkulimit konform rregullores për furnizim me energji elektrike dhe përfshinë periudhën kohore 12 muaj, nëse i referohemi te njëjtit nenë 31kjo përllogaritje mund te behet vetëm atëherë kur nga pala e dëmtuar nuk mund te konstatohet koha e fillimit kyçjes se pa paautorizuar me energji elektrike nga konsumatori familjar për 6

muaj, kurse për biznese 12 muaj, ky fakt nuk qëndron ani pse ekspertiza financiare nga eksperti V.I ka dhënë te njëjtën shume duke i fal besimin faktuarës se bërë nga e dëmtuara, nëse gjykata do te analizoj procesverbalin e seancës gjyqesore dt.05.05.2021 gjate deklarimit te ekspertit financiar do te vërtetoj shperputhje te plota ne qe eksperti ka nënvizuar ne ekspertizën e dt. 14.04.2021.

Prokurori i shtetit ka anashkaluar kohen e hyrjes ne shfrytëzim te pronës nga i akuzuari fakt i vërtetuar edhe nga kontrata e qirasë e qe rrjedhimisht e vërteton edhe shfrytëzimin e energjisë elektrike, atëherë si mund te akuzohet Xh.V per kohen qe nuk ka qene ne shfrytëzim te njehsorit, andaj si mbrojtje i kërkon gjykatës te vlerësoj kontratën e qirasë, pasqyrën e tatimit, rregulloren nenin 31 për energji elektrike, e tek pastaj të nxjerr vendim meritor ashtu qe te akuzuarin ta liroj nga akuza. Por nëse gjykata vlerëson se me prova i akuzuari është fajtor atëherë ti shqiptoj një dënim minimal.

I akuzuari Xh.V, ne fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështet avokaten mbrojtëse, tjetër nuk ka çka te deklaroj.

Vlerësimi lidhur me dënimin e shqiptuar

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin se është mbajtës i familjes dhe se nuk ka dëshmi të ketë qenë i dënuar më parë për ndonjë veprë penale, ndërsa sa u përket rrethanave rënduese gjykata vlerësoj peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit, faktin se i njëjti ushtron një veprimtari biznesi të metalurgjisë, i njëjti edhe në bazë të gjendjes ekonomike duhet të jetë pagues i rregullte i shërbimeve publike, andaj duke marrë parasysh tërësinë e këtyre rrethanave, të akuzuarit i shqiptoi dënim me gjobë ashtu siç është theksuar edhe në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindjen se në rastin konkret do të arrihet qëllimi i dënimit në kuptim të preventivës speciale dhe asaj gjenerale, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejtë në raport me peshën e veprës penale.

Kërkesa pasurore-juridike dhe shpenzimet e procedurës penale

Në kuptim të nenit 463 par.1 dhe 2 të KPPK-së, gjykata ka obliguar të akuzuarin që në emër të dëmit të shkaktuar KEDS-it në Ferizaj, t'ia kompensoj dëmin në shumën prej 4117.42€ si në dispozitiv të aktgjykimit.

Vendimi mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor dhe shpenzimet e procedurës penale është marr në kuptim të dispozitës së nenit 453 par. 1 lidhur me nenin 450 par.2 nënpar.2.6 të KPPK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 39 par 3 pika 3.1, Nr. 05/L-036 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Në bazë të theksimeve më lartë, është vendosur si në dispozitivit të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Departamenti Përgjithshëm-Divizioni Penal

P.nr.1014/20, të datë 03.06.2021

**Procesmbajtëse
Florijana Pajaziti**

**Gjyqtari i vetëm gjykues
Irir Bytyqi**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.